



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-32/16</u>
Nr. l faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>08-01-2016</u>
Nr. pages	Date



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 08.01.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4269, për z. Bekim Jakupi, Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike Lokale Ngrohtorja e Qytetit "Termokos" - Prishtinë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Bekim Jakupi, Kryesues i Bordit në Ndërmarrjen Publike Lokale Ngrohtorja e Qytetit "Termokos" - Prishtinë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë, z. Jakupi, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuara një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast z. Jakupi është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj, neni 16 (paragrafi 3), të Ligjit nr.04/L-051. Prandaj si zyrtari i lartë publik është i obliguar të bartë menaxhimin e biznesit të ndonjë personi i besuar, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Jakupi ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Jakupi ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/4736/15), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni menaxherial në biznesin privat N.Sh "Intelkos Consulting.

Po ashtu zyrtarit të lartë sipas nenit 16 (paragrafi 2), të Ligjit nr.04/L-051, i është bërë e ditur që gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 16.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

